



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 44-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 03.06. 2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Fitim Shala, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Egzona Bytyqi, anëtare
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Fehmi Rexhepi, anëtar
29. Argjend Tasholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Anila Reçica, DKRS
5. Emina Rexhiq, DPU
6. Valon Pacolli, DA
7. Bekim Shabani, DEZH
8. Sefer Tasholli, DGJK
9. Merita Bytyqi, DSH
10. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
11. Nazim Gashi, DMSH
12. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj të jeni mirë dhe të keni shëndet.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit; Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 42 dhe 43 të (e jashtëzakonshme) e kevendit.

2. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e taksave komunale .

3. Propozim Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore " Afrim Zhitia " , " Mbreti Zog " dhe " Kongresi i Blinajës " në Lipjan .

4. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021-2029 .

5. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit .

Ka pasë një propozim në KPF nga Lumturije Bytyqi-Hasani, që të jetë në rend të ditës pika rreth përzgjedhjes së këshillave të fshtarave, e cila do të jetë në muajin qershor ku do ta kemi edhe një mbledhje.

Patsj kryesuesi pyeti anëtarët e kuvendit se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës

Megë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pastaj u vazhdua me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Lumturije Bytyq-Hasani, tani më dihet që Qeveria ka paralajmëruar që do të bëhet vaksinimi i qytetarëve me 15 qershor. A i keni bërë të përgatitjet që vaksinimi të filloj në sallën "Beter life" qysh parashihet?

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje për ekzekutivin sa është shkalla e dëmtimit të rrugës Lipjan-Rubofc, dhe sipas inspektoratit sa përqind është dëmtuar ajo rrugë deri tani.

Ramiz Qeriqi, tha se kam disa pyetje, e para rruga "Shqipëria" dhe "Hajredin Bajrami" kanë qenë 4 korsi tani janë duke u punuar vetëm 3 korsi pse? Po e du një sqarim? Po ashtu të rruga "Skënderbeu" është shqetësim i qytetarëve që të mos punohet gjatë sezonit verorë për shkak se i dëmton bizneset e tyre. Po ashtu, një gurthyes në Shalë po shkakton dëme të banorët dhe është mirë me ndërhy komuna. A kanë pëlqim këta gurthyes apo janë duke pa punuar pa pëlqim. Familja e heroit "Bashkim Krasniqi" kanë bërë kërkesë por ju ka refuzua, pse është refuzuar kjo kërkesë?

Lulzim Rrustemi, kam një pyetje si janë bërë kriteret për ndarjen e mjeteve për dëmet e shkaktuara nga vërshimet. Dhe po shpresoj që lumi Janjevka të gjejë vend dikund në buxhet për intervenim se për ndryshe do të ketë prap probleme.

Merita Bytyqi, sa i përket çështje se vaksinimit zyrtarisht pritet me filluar me 15 qershor, përgatitjet duhet me kanë edhe prej Ministrisë dhe Institutit, ndërsa përgatitjet tona janë bërë edhe më herët.

Imri Ahmei kryetari i Komunës, për vaksinimin kemi marr vendim me shkrim që salla "Beter Line" të jetë për vaksinim. Rruga Lipjan - Kojškë Rubofc është e dëmtuar në tersi se na ka sjell telashe, lejen ja ka dhanë Ministria jo ne përveç saj po na dëmtohen edhe rrugët tjera. Ne duhet me shti atë rrugë në parashikimet buxhetore. Nëse keni ndonjë ide ka me krijuar ndonjë rrugë alternative na tregoni. Rruga "Shqipëria" dhe "Hajredin Bajrami" është fyt i ngushtë dhe ka gjerësinë vetëm 13.52 dhe kaq do të bëhet rruga se nuk do të kemi mundësi me zgjerua se nuk kemi mjete për shpronësim. Ndërsa Rruga "Skënderbeu" nuk ka telashe, por nuk e kemi filluar deri sa të kryhet rruga para komunës, dhe ajo rrugë besoj që do të kryhet për 2 apo 3 ditë pasi që është vetëm riasfaltim. Gurthyesit në Shalë nuk e di a ju ka vazhdua ose jo, dhe nuk kemi pronë ne aty si komunë. Licencat gurthyesit po i marrin nga Ministria. Nuk është refuzuar kërkesa për labidarin e Bashkim Krasniqi por unë bile ju kam kushtuar rëndësi të jashtëzakonshme lapidarëve dhe duhet të gjendet hapësira për këta. Ku së

shpejti do të bëhet plaka përkujtimore në Sllovi te Lugu i Dëmës e vendet tjera të shtëpia e kulturës e Tahir Sinanit. Sa i përket vlerësimit të dëmeve nuk i di kriteret cilat janë marrë. Përparësi iu është dhënë atyre që janë në listë të asistencës sociale.

Ramiz Qeriqi, është kërkesë e bizneseve që mos të punohet në kohën kur do të vinë gurbetgjit. Për heroin Bashkim Krasniqi është mirë me më thirrë mu, unë ua jepi të dhënat për këtë dëshmor dhe dëshmorët tjerë.

Imri Ahmeti kryetar i komunës, rruga “Skënderbeu” nuk do të bllokohet por do të kryhet për dy ose 3 ditë dhe do të kryhet ditëve të vikendit. Neve nuk na mungon vullneti me u marr me dëshmorët por mungon vullneti i shoqatave. Unë jam i gatshëm që të gjejmë se bashkë të gjithë një zgjidhje. Në pronën e komunës do të ndërtohet rruga dhe ne nuk do të bëhet shpronësimit por vetëm në pronën e komunës.

Ramiz Qeriqi, unë e falënderoj kryetarin për përgjigjen e dhënë.

Albulena Kelmendi, tha se kam një ankesë të qytetarëve për shkak të volumit të madh të muzikës së zërit të ngritur nga kafiteritë. Si do të bëhet çështja e zgjidhjes së parkingjeve kur dihet që tash ka filluar me u rrit fluksi i qytetarëve për shkak të ardhjes së mërgimtarëve.

Imri Ahmeti kryetari i komunës tha se zhurma e muzikës së kafiterive një fenomen që na ka përcjellë sezonin e verës që disa vite, me të drejtë e ngritur dhe duhet të marrim një vendim për këtë çështje. Çështja e parkingjeve ka shkaktuar probleme sidomos kjo rruga për ndaje deri në 5 minuta. Ne do ta shpallim tregun vend për parking përveç ditës së hane.

Majlinda Sylejmani, tha kam një pyetje rreth projektit të shëtitorës në Gadime. A janë duke u zhvilluar punimet dhe kur pritet me përfunduar. Po ashtu edhe për shtigjet e ecjes në Lipjan kur pritet me u finalizuar si projekt.

Argjend Tasholli, kam një kërkesë të banorëve të fshatit Marevc që kenë edhe trotuarin pasi që ndriçimi publik po bëhet, pasi që po rrezikohen fëmijët e tyre. Qytetarët e lagjes Publica në Dobrajë kërkojnë që të hyjë kanalizimi edhe në lagjen e tyre dhe të asfaltohet dhe pjesa e tyre. Një kërkesë që të përfshihet në projektin e mirëmbajtjes edhe pjesa e Gadimes poshtë deri në Babush.

Rasim Hasani, shëtitorja në Gadime punimet janë duke u zhvilluar me dinamikën e paraparë. Edhe shtigjet e ecjes janë në fazën finale. Trotuari Marevc-Gadime do të shohim me shti në projekt. Kanalizimi në Dobrajë shumë shpejt do të filloj edhe pjesa e mbetur së bashku me rrugicat.

Imri Ahmeti, është lidh kontrata për lagjet Publica në Dobrajë dhe Reqica në Gllavicë e disa vende tjera. Është duke u bërë mirëmbajtja e disa projekteve. Për trotuar nuk kemi mjete për Gllavicë, atje do ta bëjmë edhe një fushë të sportit.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 42 dhe 43 të (e jashtëzakonshme) e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstrakte të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e 42 dhe 43 të e Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 42 dhe 43 të (e jashtëzakonshme të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II.

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e taksave komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasani drejtor DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne si grup parlamentar i PDK-s patëm kërkuar që të zgjerohet dhe te përfshihen edhe bizneset që janë dëmtuar nga pandemia sidomos gastronomia. Ne e përkrahim këtë propozim vendim dhe ne kërkojmë që komuna që ti lejojnë ta shfrytëzojnë pronën vetën në pjesën për të cilën kanë leje.

Shkelzen Bislimi, një propozim shumë i mirë pasi që bizneset janë dëmtuar gjatë pandemisë. Ne si grup e mbështesim këtë propozim vendim.

Ramiz Qeriqi, një propozim vendim shumë i mirë të cilin e përshëndes. Pata kërkuar edhe në mbledhjen e kaluar po kërkoj prapë që të ju zvogëlohet pagesa e

qerasë personave qe kanë përfituar banesa sociale. Kisha kërkuar qe të ju bëhet pagesa e qerasë,10 euro . Po ashtu kisha kërkuar qe te lirohen edhe trasat qe janë private. Ata të cilët kanë bërë pagesa a do të ju kthehen mjetet.

Majlinda Sylejmani,ne e kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar këtë propozim vendim dhe si grup i LDK-s, e përkrahim,ku kjo ka për qëllim lehtësim për bizneset pas gjendjes nga pandemia.

Afrim Miftari,edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim dhe e përkrahim,pasi me këtë ju dilet në ndihmë bizneseve te cilat janë dëmtuar nga pandemia siç janë gastronomia dhe autotaksit dhe me këtë do të krijohen sado pak lehtësira për këto biznese.

Rasim Hasani,lirohen nga pagesa shfrytëzuesit e hapësirave publike vetëm ata qe kanë leje për shfrytëzim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për aprovoi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën në vazhdim

III

Propozim Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore “ Afrim Zhitia ” , “ Mbreti Zog ” dhe “ Kongresi i Blinajës ” në Lipjan .

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tasholli drejtor i DGJK-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi,para vetes kemi një propozim për shpronësimin e 3 segmenteve rrugore të cilat janë në interesin e qytetarëve, por i kemi disa dilema te pjesa e tretë te “Kongresi i Blinajës ” në Lipjan pse atje nuk është vazhduar sipas planit plus kemi pasuri shoqërore nuk e di a e keni konsultuar ligjin ose jo,nuk e di sakte a guxojmë me bo shpronësim ne pasuri shoqërore. Qeverisja e Lipjanit ka dalë si qeveri e shpronësimit dhe këtu publikisht e ka thanë kryetari qe nuk do të bëjë shpronësim të pronave private. Dhe ne nuk do ta votojmë këtë propozim por do të abstenojmë.

Albulena Kelemendi,ne e kemi diskutuar dhe edhe ne KPF,nuk e kemi te qartë shpronësimin te rruga e tretë Kongresi i Blinajës ” në Lipjan, ku jemi konfuz sa i përket

ligjshmërisë së këtij vendimi. Nuk e di qysh një tokë që ju ka dhënë dikunja për 99 vite prej AKP-s, mundet me u shpronësuar. Ne nuk mundemi me aprovuar diçka të cilën e kemi të pa qartë.

Afrim Miftari, këtu kemi të bëjmë me një propozim për shpronësimin e 3 segmenteve të tri rrugëve të ndryshme ku e kemi diskutuar edhe në KPF dhe konsiderojmë që është në të mirën e qytetarëve pasi që ju krijon lehtësira qytetarëve dhe që çdo rrugë alternative është e mirëseardhur për qytetarët.

Sefer Tasholli, problemi i vetëm ku ju po hezitoni është te segmenti “Kongresi i Blinajës” por aty po bëhet për të mirën e qytetarëve. Këtu është vetëm një segment, ku do të shpronësohen vetëm dy prona private.

Imri Ahmeti, nga viti i ardhshëm nëse do jme me shpronësuar një rrugë duhet me paraparë edhe projektin dhe kostoja do të futet në buxhetin e paraparë. Është kërkuar prej kryetarëve të komunave kjo të ndryshohet. Kërkoj nga anëtarët e kuvendit që kjo të aprovohet.

Megjë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 1 abstenim, aprovoi:

Pastaj Kryesuesi dha pauzë nga ora 12:00 deri në 13:00

U vazhdua me pjesën e dytë të mbledhjes me pikat në vazhdim

IV

4. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021-2029

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiq, drejtoreshë i DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi:

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, një plan shumë i rëndësishëm për komunën tonë, Hartat Zonale janë bërë në bashkëpunim me Gizin Gjerman. Unë kam pyetje cila është kompania konsulte e cila është zgjedhur sipas prokurimit publik pasi që në debate publike nuk e kemi pa kompaninë. Është mirë me u njoftuar kuvendi se cila kompani ka punuar në hartat zonale. Janë bërë 1 vit deri në hartimin e draftit final të hartave zonale. Në zonën urbane të Lipjanit ku janë caktuar zona sub urbane, urbane dhe e përgjithshme. Kjo e përgjithshme i përfshin edhe disa zona si B2, B3 e tjera. Ndërsa B6, B7 prona individuale. Unë i kam disa vërejte dhe propozime, zonat komerciale janë përbush nga kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, E kam një propozim të zonat komerciale të disa rrugë ka ndërprerje nuk është dashtë me u ndërpre po me vazhdua njëjtë. Po ashtu kemi disa shprehje të zonave. Po ashtu të kisha në Lipjan duhet me ditë qytetarët që është zonë e mbrojtur, qysh i keni bo kufizimet këtu. Po ashtu të tregu

e keni lënë zone rekreative shfrytëzuese na si GP i PDK-s e kemi pas një propozim që komplet tregun të bëhet park. Lipjani nuk ka park ne bazë të hartës i ka vetëm dy pika të gjelbërua dhe janë minimale për qytetarët e komunës së Lipjanit. Po ashtu nuk ka përcaktim të lokacionit të institucioneve arsimore.

Imri Ahmti, Kryetari i komunës, jam falënderues Gizit Gjerman dhe kompanisë Global konstruksion e cila ka qenë kompania e kontraktume. Një marrëveshje bashkëpunimi me mes komunës tone dhe Gizit Gjerman projekti i hartave zonale që 3 vite duke punuar. Po ashtu e falënderoj edhe ministrin aktual z.Liburn Aliu e cili ju ka dhënë shtyrje hartave zonale të të gjitha Komunave. E di që nuk është ideale ka mundësi për përmirësime dhe avancime, të gjitha ankesat dhe përgjigjet kanë qenë publike, e ku i falënderoj të gjithë zyrtarët për punën që kanë bërë. Është bërë një punë shumë e mirë në hartat zonale. Sipas udhëzimeve administrative shënohet rekreacion e jo park. Këto harta zonale është mirë që po kryhet dhe janë mbajtur dëgjime publike në të gjitha lokalitetet ku keni mujtë me i dhënë propozimet dhe vërejtjet e juaja. Kërkoj nga ana juaj që ta aprovoni këtë propozim. Janë të parapara edhe institucionet e arsimit dhe institucionet tjera me këto harta.

Ganimete Qeriqi,kam një pyetje në kuadër të këtyre që po përmendet parket ,bizneset,parkingjet rekreacionet , të hartat zonale a keni menduar ndonjëherë të ndahet një lokacion për pishinë ku aty nxënësit mund ta zhvillojnë aktivitetin e notit.

Ramiz Qeriqi, edhe pse kemi prit shumë për hartat zonale por kam disa paqartësi pse në të njëjtin vend dikush mund të ndërtojë deri në 11 kat dikush tjetër 8 e tjetri 4 pse me ndodh kjo kështu.

Hyra Bytyçi,hartat zonale një dokument mjaft i rëndësishëm për komunën tonë e sidomos për qytetin e Lipjanit. Ne si grup parlamentar i LDK-s jemi pro këtij propozimi. Ne besojmë në punën e ekspertëve dhe atyre që kanë punuar në këtë dokument dhe jemi falënderues ndaj Gizit dhe drejtoratit të Urbanizmit për finalizimin e këtij dokumenti.

Imri Ahmeti,kryetari i komunës,tha me harta zonale do të përfitojnë të gjithë qytetarët e komunës së Lipjanit. Ne çdo kërkesë dhe ankesë për harta zonale e kemi shqyrtuar.

Ramiz Qeriqi,une thash se në të njëjtin vend dikujt iu ka dhanë leja për ndërtim deri në 11 katësh, dikujt 8 e 4 katësh

Imri Ahmeti kryetar i komunës ,tha nuk do të ndërtohet 11 katësh me harta zonale në Lipjan.

Lulzim Rrustemi,zona e banimit po shkon deri te sitnica ndërsa pjesa tjetër deri te fabrika e letrës, këtu dy parqe kanë ngjyre tjetër dhe Lipjani nuk ka park. Tani është hiç tregu dhe aty duhet të bëhet parku se më kurrë Lipjani nuk do të mund të bëjë park.

Imri Ahmeti, aty është zonë rekreative pasi qe me udhëzim administrativ ashtu thuhet. Në Lipjan janë edhe 7 hektarë tjera.

Lulzim Rrustemi,ngjyrat e hartës tregojnë se cilat pjesë do të jetë park ose jo ne Lipjan.

Imri Ahmeti, hapësirat publike ne Lipjan janë shtuar 300 % ne raport me vitet e më hershme. Dhe do të ketë edhe parqe dhe zona rekreative tjera .

Hana Berisha,ne bazë të hartave zonale te tregu i gjelbër aty llogaritet si zonë rekreative sipas udhëzimit administrativ.

Lulzim Rrustemi,na do të abstenojmë në votim.

Imri Ahmeti, kam një propozim nga rruga e Konjuhit deri te hekurudha te hiqet ndërtimi i lartë të jetë ndërtim individual.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për,1 kundër dhe 8 abstenime aprovoi:

Shtesë:Vendimi.

V

5. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit .

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit, drejtor i DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Nazmi Krasniqi,ne e përkrahim këtë propozim dhe si komision e kemi shqyrtuar çdo dokumentacion dhe shpresojmë qe komuna jone do te ja sheh hajrin.

Lulzim Rrustemi,ne nuk e dimë çka prodhon kjo fabrikë nuk kemi dokumentacion se çka do të punoj çka do të prodhoj.

Bekim Shabani,i ka disa veprimtari siç janë të cekura në dokumentacionin mbështetës po ashtu i ceka edhe gjatë njoftimit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për 2 abstenime, aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,¹⁵

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi